

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 7 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Pa dashur të qëndroj te thelbi i marrëveshjes, e cila, në fund të fundit, është një marrëveshje formale, mendoj se është momenti më i mirë për të bërë një përmbledhje objektive bazuar vetëm në dokumente dhe fakte lidhur me atë se çfarë ka ndodhur me pandeminë dhe se cila është e vërteta e administrimit të saj. Cila është doza e propagandës mbi të dhe cila është ajo që kanë vuajtur qytetarët në kurriz të tyre dhe që e vuajnë edhe në këtë moment që flasim bashkë? Së pari, që në ditën e parë të saj e gjithë pandemia nuk është konceptuar asnjëherë si një sfidë e vërtetë mjekësore, por është konsideruar një sfidë propagandistike. Të gjitha mesazhet dhe orientimet kanë qenë njëri më i gabuar nga tjetri. Këtu nuk kemi të bëjmë fare me çështjen e famshme të përdorimit ose jo të pandemisë, por kemi të bëjmë as më shumë dhe as më pak me një menaxhim të gabuar, i cili sjell pasoja dhe me të cilin, sigurisht, nuk mund të konformohemi as profesionalisht dhe as politikisht. Asnjë nuk mund ta harrojë, sepse jemi në këtë sallë, pavarësisht se lumenjtë e propagandës janë goxha të mëdhenj dhe të tërbuar, se mesazhi më negativ për kontrollin e pandemisë u dha që më 17 mars, kur vetë Kryeministri deklaroi: “Ne nuk kemi nevojë të bëjmë teste”. Përkundrajt gjithë globit, që shprehej për të bërë teste në kuptimin më të plotë të fjalës, sepse ishte diagnozë për të ndarë të infektuarin nga i pa-infektuari, ky ishte mesazhi i parë që u dha, ai për të cilin është emfatuuar kaq shumë përdorimi i maskave.

Më 18 mars, ishte pikërisht Kryeministri që tha se maska nuk është e nevojshme, nuk e tha opozita. Pra, po t'i lësh qytetarët pa testim, pa mjetin mbrojtës, për të cilin u vunë mijëra e mijëra gjopa dhe këto t'ia kalosh opozitës, besoj se kjo është një hipokrizi, pak të thuash e turpshme. Meqë po flitet për çështjen e inteligjencës së popullit, populli është kaq inteligjent, sa t'i mbajë mend shumë mirë këto tmerre që ka dëgjuar nga realiteti. Po shkoj më tutje për një çështje tjetër. Kryeministri ka arritur të thotë, dhe po e cilësoj: “Ka edhe mendime që nxitja e testeve është e lidhur me interesa financiare të lobëve farmaceutike”. OBSH-ja thoshte testim, edhe kur ne të gjithë thoshim testohuni, ata që thoshin teste kishin të bënin me lobet financiare. Po shkoj te dy të vërteta të mëdha: cilat janë shifrat dhe cili është trajtimi që u është bërë qytetarëve? Sa u takon shifrave, ato flasin vetë, pasi janë mbi 150-160 milionë euro të dala nga xhepat e shqiptarëve e rimbursimi i tyre është pak të thuash qesharak. Ajo që i vë vulën, sipas fakteve, jo sipas interpretimeve të mia, sepse dihet që më 18 nëntor të vitit 2020, 9 muaj e gjysmë pasi pandemia kishte filluar, u mor vendimi për rimbursimin e barnave. Kjo është një e vërtetë që nuk e luan topi.

Po shkoj tek të vërtetat e numrave, sepse besoj që qytetarët kanë nevojë për fakte. Nga dy studime të njëpasnjëshme, jo të sponsorizua nga opozita, por nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, u pohua që në fund të dhjetorit popullata ishte 25% e imunizuar, nuk kishte filluar vaksinimi, gjë që do të thotë se 750 mijë qytetarë ishin infektuar. Sa ishin shifrat zyrtare? Ishin 55 mijë, shifra, të cilat secili mund t'i konsultojë, sepse janë marrë pikërisht nga ato shifra zyrtare, publike për të tërë. Ju lutem, a mund të më thoni që është 14 herë më e vogël se sa shifra reale? 55 mijë janë të regjistruar, sepse shërbimi shëndetësor i njej, por këta qindra, mijëra të tjerë? Po i referohem momentit aktual, kur sërish Akademia e Shkencave thotë se gati 73-74%, pra gati treçerek i popullatës është e imunizuar, që do të thotë rreth 2 milionë e 150 mijë njerëz. Hajdeni të bëjmë llogaritë, sepse nuk besoj se keni në mend të dëgjoni më propagandë, pasi kjo vajti përtej të gjitha llojeve të respektit për publikun! E

pranojmë që 800 mijë njerëz janë të vaksinuar me të dyja dozat, si dhe për 175 mijë rastet e tjera, ashtu siç e thotë Ministria e Shëndetësisë, pa lëvizur presjen, por na del që 1 milion e 400 mijë shqiptarë nuk ndodhen në asnjë defter dhe nuk dihet se çfarë bëhet me ta, nuk dihet se kush paguan për ta, nuk dihet sa vdesin nga ta, sepse nuk verifikohen si raste. Kjo do të thotë qartazi që të vërtetat e thëna në këtë sallë dhe rrahjet e gjoksit janë shumë larg realitetit dhe se është një turp i madh të rrahësh gjoksin në pandemi. Po shkoj më tutje. Të gjithë e dinë se beteja me pandeminë vazhdon edhe sot e kësaj dite. Besoj se asnjë nuk e ka harruar, unë nuk kam ndër mend të harroj, sepse, nëse këta duan të bëjnë harraqin e madh, le ta bëjnë për vete, por jo ne. Që nga muaji qershor Kryeministri dilte e thoshte me treguesit që kishte: “Uau, Shqipëria e para në botë për pandeminë!”. Çfarë kishte bërë Shqipëria që ishte e para në botë? Nuk testonte, pra nuk kishte vërtetë. Këto nuk i kam thënë unë, por i ka thënë ai. Po ku ishte Shqipëria e para në botë më 2 qershor me Shqipërinë e dhjetorit të 2020-s, të janarit, të shkurtit, me shifra katastrofike, ku të gjithë shqiptarët kanë qenë me të drejtë të terrorizuar nga vdekjet pa fund, të cilat përcillnin?

Të thuash të vërtetat, nuk do të thotë të bësh politikë. Kush do t'i fshehë të vërtetat, ai bën politikë me pandeminë. Kjo është e vërteta që po ndodh, këta janë numra kokëfortë, kjo është një analizë e palëvizshme, sepse është reale, duke përdorur pikërisht të dhënat, jo rastësisht kam përdorur të dhënat zyrtare të këtyre. Po t'u nisem interpretimeve të mia, për hir të eksperiencës shumë të gjatë në këtë fushë do të kisha të tjera, por për t'ju hequr çdo mundësi që të bëjnë propagandë këto janë të dhënat dhe faktet. Gjithashtu, ju e dini shumë mirë se të gjithë hapat e mëtejshëm që u morën ishin të tillë ku edhe shërbime të mëdha kapilare, siç ishte shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor, u aktivizuan me vonesë në kohën kur pandemia kishte dalë përfundimisht jashtë kontrollit. Kjo është e vërteta e pandemisë. Këto të vërteta janë të hidhura për shqiptarët, sigurisht, nuk janë të hidhura për qeverinë, e cila ka vendosur vetëm e vetëm të bëjë propagandë nga fillimi deri në fund. Faleminderit!